

**URDHËR<sup>1</sup>**  
**Nr. 545, datë 19.5.2026**

**PËR MIRATIMIN E SËMUNDJEVE TË LISTUARA, QË U NËNSHTROHEN  
PROGRAMEVE TË MBIKËQYRJES NË VEND, SHTRIRJEN GJEOGRAFIKE TË  
KËTYRE PROGRAMEVE DHE SËMUNDJET E LISTUARA, PËR TË CILAT  
VENDOSET STATUSI I PASTËR NGA SËMUNDJA I NDARJEVE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 30, dhe pikës 1, të nenit 37, të ligjit nr. 41, datë 26.6.2025, “Për shëndetin e kafshëve”,

**URDHËROJ:**

**Neni 1**

Sëmundjet e listuara që u nënshtrohen programeve të mbikëqyrjes në Republikën e Shqipërisë në përputhje me nenin 28, të ligjit nr. 41, datë 26.6.2025, “Për shëndetin e kafshëve”, dhe shtrirja gjeografike e programeve të tilla përcaktohet në shtojcën I të këtij urdhri.

**Neni 2**

Sëmundjet e listuara për të cilat vendoset statusi i pastër nga sëmundja i ndarjeve në përputhje me nenin 37, të ligjit nr. 41, datë 26.6.2025, “Për shëndetin e kafshëve”, janë përcaktuar në shtojcën II të këtij urdhri.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër botohet në Fletoren Zyrtare dhe fillon të zbatohet nga data 11.7.2027.

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**  
**Andis Salla**

**SHTOJCA I**

| <b>SËMUNDJET E LISTUARA QË U NËNSHTROHEN<br/>PROGRAMEVE TË MBIKËQYRJES</b>     | <b>SHTRIRJA GJEOGRAFIKE E<br/>PROGRAMEVE TË MBIKËQYRJES</b> |
|--------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------|
| <b>Gripi i shpendëve me patogjenitet të lartë</b>                              | <b>I gjithë territori i vendit</b>                          |
| <b>Infeksioni me viruse të gripit të shpendëve me<br/>patogjenitet të ulët</b> | <b>I gjithë territori i vendit</b>                          |

**SHTOJCA II**

| <b>SËMUNDJET E LISTUARA PËR TË CILAT VENDOSET STATUSI I PASTËR NGA SËMUNDJA I<br/>NDARJEVE</b> |
|------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Nekroza hematopoietike epizootike</b>                                                       |

<sup>1</sup> Ky urdhër është përafëruar plotësisht me Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2020/690 e datës 17 dhjetor 2019, që përcakton rregullat për zbatimin e Rregullores (BE) 2016/429 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me sëmundjet e listuara që u nënshtrohen programeve të mbikëqyrjes së Bashkimit Evropian, shtrirjen gjeografike të programeve të tilla dhe sëmundjet e listuara, për të cilat vendoset statusi i pastër nga sëmundja i ndarjeve, FZ L 174, datë 3.6.2020, f. 341–344.

|                                                                                               |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------|
| Septicemia hemorragjike virale                                                                |
| Nekroza hematopoietike infektive                                                              |
| Infeksioni me rajonin shumë polimorf (HPR) fshihet me virusin e anemisë infektive të salmonit |
| Infeksion me <i>Microcytos mackini</i>                                                        |
| Infeksion me <i>Perkinsus marinus</i>                                                         |
| Infeksion me <i>Bonamia ostreae</i>                                                           |
| Infeksion me <i>Bonamia exitiosa</i>                                                          |
| Infeksion me <i>Marteilia refringens</i>                                                      |
| Infeksion me virusin e sindromës Taura                                                        |
| Infeksion me virusin e kokës së verdhë                                                        |
| Infeksion me virusin e sindromës së njollave të bardha                                        |
| Gripi i shpendëve me patogjenitet të lartë                                                    |
| Infeksioni me virusin e sëmundjes së Pseudopestit                                             |